



Organizata: Rrjeti i Organizatave “Zëri i te rinjve”

Rruga “Bulevardi Bajram Curri”, Nd. 280, H5, Ap.4, Tiranë 1015
www.youthvoicenetwork.org
albyouthvoice@gmail.com

Thirrje për Pozicion: Koordinator Projekti (part-time)

Termet e Referencës

Date: 10 Maj 2022

Rrjeti i Organizatave "Zëri i të Rinjve" është një organizatë joqeveritare e krijuar më 20 korrik 2018 me mision mobilizimin, integrimin dhe fuqizimin e potencialit rinor nëpërmjet ndërgjegjësimit, informimit, advokimit dhe shërbimet e lobimit në fushën e arsimit, kujdesit, shëndetësisë dhe punësimit.

Përshkrimi i punës

Koordinatori i Projektit është një pozicion pjesë e stafit të brendshëm të Organizatës. Fokusi kryesor i punës së koordinatorit qëndron në sigurimin e efektivitetit në menaxhimin e projekteve duke ofruar rezultatet e duhura teknike, operative, financiare dhe administrative gjatë ndjekjes së zhvillimit të projektit përmes monitorimit, vlerësimit dhe raportimit gjatë çdo faze të tij.

Koordinatori i Projektit do të punojë nën drejtimin e drejtorit ekzekutiv dhe do të jetë përgjegjës për implementimin e aktiviteteve të projektit që koordinon.

Në këtë kuadër, ai siguron që rezultatet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet përkatëse, marrëveshjet dhe kontratat duke arritur menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të punës me qëllim dorëzimin në kohë të rezultateve të projektit.

Stafi i “Zëri i te rinjve” do të mbështesë personin e përzgjedhur për gjatë punës së tij pranë apo jashtë zyrave të organizatës. Çdo detyrë e kryer nga Koordinatori duhet të jetë në përputhje me rregullat dhe politikat e rrjetit si dhe kërkesat e donatorëve.

1. QËLLIMI I PUNËS

Koordinatori i projekti është përgjegjës për:

- a) koordinimin e punës së projektit/projekteve
- b) monitorimin dhe sigurimin e mbështetjes së zbatimit të projekteve në zonat e përfshira në projekte dhe punon për rritjen e numrit të vullantarëve të rinj



- c) raportim i vazhdueshëm
- d) promovimin e aktiviteteve ne rrjetet sociale dhe ne ëbsite

2. Detyra dhe përgjegjësi

- Të zbatojë aktivitet e përfshira në projekte, duke përfshirë dhe asistencën teknike dhe logjistikën për të gjitha aktivitetet, pavarësisht natyrës, të planifikuara në projekt duke përfshirë degët e shoqatës.
- Të zbatojë aktivitet e përfshira në projekte, duke përfshirë dhe asistencën teknike dhe logjistikën për të gjitha aktivitetet dhe takimet e planifikuara në projekt duke përfshirë anëtarë, edukatorë bashkëmoshtar si dhe vullnetarë
- Të bashkëpunojë me stafin e financës për të zbatuar aktivitetet dhe disbursuar buxhetet përkatëse në kohë me aprovimin e drejtorit ekzekutiv.
- Të dokumentojë të gjitha aktivitetet e projekteve duke i rakorduar me shpenzimet e buxhetit.
- Të shkruajë projekt propozimeve në përputhje me misionin e organizatës dhe objektivat strategjikë të saj, sipas kërkesave të drejtorit ekzekutiv.
- Të bëjë vizita në terren (sipas projekteve) për të monitoruar progresin dhe të raportojë tek drejtori Ekzekutiv .
- Të krijojë lidhje me partnerët që veprojnë në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues, barazisë gjinorë, angazhimi qytetar, të rinjtë, paqa dhe siguria dhe që janë të orientuar ndaj çështjeve të të rinjve pavarësisht fushave që mbulojnë.
- Të gjejë rrugët për rritjen e numrit të vullnetarëve të rinj të shoqatës dhe të monitorojë aktivitetin e tyre lidhur me YPEER dhe Champions4Life
- Siguron përditësimin e Sistemit të Raportimit GPS të UNFPA_së.
- Dokumenton rezultate/arritjet, dhe proceset e projektit dhe ofron informacion për UNFPA-në apo donatorë të tjerë me kërkesë dhe/ose miratim të drejtorit ekzekutiv; raportet; gazetat, rastet studimore të shoqatës sipas kërkesës.
- Duke u konsultuar me Drejtorin Ekzekutiv identifikon nevojat për asistencë teknike të projektit dhe ekspertët e përshtatshëm që mund të japin këtë asistencë.
- Mban të informuar Drejtorin Ekzekutiv dhe kolegët lidhur me zhvillimet dhe progresin në zbatimet e projektit.
- Merr pjesë në takime, evente, trajnime duke përfaqësuar YVNO pasi është rënë dakord me Drejtorin Ekzekutiv.
- Promovon aktivitetet, para dhe pas zbatimit të tyre, ne rrjetet sociale dhe ne ëbsite të YVNO-se.

3. AFTËSI



Aftësi analitike; të shkruajë raporte; administrative dhe organizuese; njohuri të mira kompjuterike; aftësi lehtësuese/trainuese; rrjedhshmëri në Anglisht. Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese si edhe përkushtimi ndaj pjesëmarrjes së të rinjve është kusht. I aftë për të artikuluar qartë në konferenca dhe takime.

4. FUSHA E VEPRIMIT

Koordinatori i projektit do të angazhohet përkatësisht në 2 drejtime kyce gjate punës së vetë, dhe do jetë i dedikuar veçanërshtë zbatimit të planit të përbashket të punës me UNFPA si dhe projekteve aktuale që rrjeti zbaton.

1) Plani i përbashkët i punës me UNFPA-në.

Rrjeti është partnerë zbatues i UNFPA për periudhën kohore 2022-2026. Cdo vit, në bashkëpunim me oficerët e programit përgatitet plani i punës i cili është i fokusuar në 3 drejtime kryesore a)Puna me të rinjtë dhe çështjet gjinore b)Puna përsa i përket të rinjve dhe shëndetit seksual dhe riprodhues si dhe fuqizimin dhe zgjerimin e rrjetit Y-PEER c) punë në agjendën mbi të rinjtë paqen dhe sigurinë. Bashkëpunimi me UNFPA-në është një bashkëpunim mjaft fluid dhe dinamik në kohë dhe hapësirë. Gjithashtu, një serë udhëtimesh brenda dhe jashtë vendit mund të ndodhin si pasojë e eventeve dhe detyrave që YVNO ka ndaj këtyre eventeve që UNFPA organizon.

2) Vullnetarët dhe edukatorët bashkëmohatar

Një element i rëndësishëm i punës së YVNO dhe veçanërisht falë punës së rrjetit Y-PEER së dhe programit Champions4Life, janë vullnetarët dhe të rinjtë. Çdo vit, YPEER kujdeset që të shtojnë numrin e të rinjve që i bashkohen rrjetit dhe angazhohen si edukatorë bashkëmohatar. Projekt koordinatori duhet të ruajë bashkëpunimin me Pikën Fokale Kombëtare të YPEER për të nxitur angazhimin e të rinjve, rritjen e nr të vullnetarëve si dhe identifikimin e të rinjve potencial për tu angazhuar me tej brenda strukturave dhe projekteve të rrjetit. Projekt koordinatori duhet të sigurojë një mekanizem për informimi dhe komunikim të vazhdueshëm me vullnetarët.

3) Rritjen e projekteve Erasmus dhe projekteve të nderja të financuar nga bashkimi europian.

Projektet erasmus KA1 dhe KA2 janë një element i shtuar për punën me të rinjtë dhe partnerët ndërkombëtar. Në kuadër të kësaj fushe veprimi, projekt koordinatori, do të angazhohet të zgjerojë platformën e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtar për të përfutuar sa më shumë nga projektet Erasmus dhe mbështetja e EU.



5. KOHËZGJATJA E KONTRATËS :

Projekt koordinatori pritet të fillojë në 1 Prill 2023 deri më 31 Dhjetor 2023, më të drejtë rinovimi të kontratës për vitin 2024.

Shënim: Kontrata, oraret dhe pagesa mund të ndryshojë në varësi të projekteve që do të menaxhohen nga ana e projekt koordinatori.

6. KRITERET PËR APLIKIM

- Diplomë Bachelor në Punë Sociale, Administrim dhe Politika Sociale, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Europiane dhe fusha të tjera të lidhura;
- Së paku 3 vite eksperiencë në çështje dhe projekte që përfshijnë rininë;
- Eksperiencë në sektorin e shoqërisë civile;
- Njohuri shumë të mira të Gjuhës Angleze;
- Aftësi shumë të mira organizative;
- Aftësi shumë të mira në menaxhimin e kohës dhe prioritizimin e punës;

7. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

- Jetëshkrim (CV)
- Leter Motivimi

8. FAZAT E APLIKIMIT

- 1) Dërgimi i dokumenteve të kërkuara
- 2) Zhvillimi i intervistës
- 3) Përzgjedhja

Subjektet e interesuara duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës 5 Prill 2022, në adresën elektronike: albyouthvoice@gmail.com ose fizikisht ne adresën: Rruga “Bulevardi Bajram Curri”, Nd. 280, H5, Ap.4, Tiranë 1015